





USAID

NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

Vlerësimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit: Shqyrtim dhe rekomandime gjashtëmujore (janar – qershor 2024)



Vlerësimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit: Shqyrtim dhe rekomandime gjashtëmujore (janar – qershor 2024)

Aktiviteti i USAID-it për Integritet të Komunave të Kosovës

DEKLARATË MOHUESE: Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) ose të qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Lista e shkurtesave

- AK** → Autoriteti Kontraktues
- D+** → Demokrasi Plus
- DK** → Dogana e Kosovës
- KEK** → Korporata Energjetike e Kosovës
- LPP** → Ligji për Prokurimin Publik
- OE** → Operatori Ekonomik
- OSHP** → Organi Shqyrtues i Prokurimit
- SML** → Sistemi për Menaxhimin e Lëndëve

Përmbajtja

Lista e shkurtesave.....	4
Përmbledhje ekzekutive	6
Analiza Krahasuese: Janar – Qershor 2023 kundrejt Janar – Qershor 2024.....	7
Hyrje	8
Numri dhe natyra e vendimeve të OSHP-së në gjashtë mujorin e parë të vitit 2024	9
Kohëzgjatja në marrjen e vendimeve dhe pasojat në prokurim publik.....	11
Vendimet e OSHP-së të atakuara në gjykata dhe lista diskualifikuese	13
Mungesa e konsistencës në vendimmarrje	15
Vonesat në vendimmarrje	16
Vendimet pjesërisht të bazuara dhe mos konfiskimi i tarifës së ankesës	18
Transparenca	20
Angazhimi i ekspertëve, gabimet dhe mostrajtimi i lëndëve në mënyrë adekuate	22
Përfundime.....	24
Rekomandime.....	25

Përmbledhje Ekzekutive

Ky raport monitorues, i zhvilluar nga Democracy Plus (D+), në kuadër të aktivitetit të USAID-it për Integritet të Komunave të Kosovë (KMI), paraqet një vlerësim të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) bazuar në vëzhgimet e kryera gjatë një periudhe gjashtëmujore, nga janari deri në qershor 2024. Monitoruesit ekzaminuan nga afër vendimet dhe praktikatat e OSHP-së për të vlerësuar paanshmërinë dhe efektivitetin e saj në trajtimin e ankesave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë (OE). Ky raport thekson disa sfida të vazhdueshme me të cilat përballlet OSHP-ja, duke përfshirë vendimmarrjen jokonsistente, gabimet e ekspertëve, vonesat në vendimmarrje dhe transparencën e pamjaftueshme.

Gjatë gjithë periudhës së monitorimit, OSHP-ja ka vazhduar të ballafaqohet me respektimin e afateve ligjore për nxjerrjen e vendimeve për ankesa. Sipas Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), nga OSHP-ja kërkohet që të nxjerrë vendime brenda 34 ditëve, me një vazhdim të mundshëm prej 20 ditësh në raste të veçanta. Megjithatë, OSHP-ja shpeshherë i ka tejkaluar këto afate, gjë që ka përkeqësuar numrin e ankesave të pazgjijdhura nga periudhat e mëparshme.

Bordi i OSHP-së ka funksionuar me vetëm tre nga pesë anëtarët e kërkuar për pjesën më të madhe të gjysmës së parë të vitit 2024. Kjo ishte për shkak të dorëheqjes së një anëtari në fund të vitit 2023 dhe shkarkimit të një tjetri, i cili më vonë u shpall jokushtetues nga Gjykata Kushtetuese. Mungesa e dy anëtarëve e vështirësojë më tej punën e bordit, duke çuar në vonesa në vendimmarrje dhe në pamundësi për të menaxhuar në mënyrë efektive ngarkesën e çështjeve.

Përkundër sfidave, ka pasur disa përmirësime në transparencën e OSHP-së, veçanërisht në përfshirjen e palëve të interesuara në diskutimet publike për ndryshimet e propozuara në Rregulloren e saj të Punës. Megjithatë, mbeten çështje të rëndësishme, duke përfshirë problemet teknike me faqen e internetit të OSHP-së, praktikatat jokonsistente të publikimit si dhe publikimi i vonuar i kërkesave për skualifikim.

Mbështetja e OSHP-së në rekomandimet e ekspertëve mbetet jokonsistente. Ndërsa ekspertët konsultohen për rastet e prokurimeve teknike, këshillat e tyre nuk janë gjithmonë të integruara plotësisht në procesin e vendimmarrjes. Kjo mospërputhje, veçanërisht në fushat teknike si IT dhe prokurimi i pajisjeve mjekësore, ka ngritur shqetësime në lidhje me ekspertizën e bordit dhe besueshmërinë e vendimeve të tij.

Gjatë periudhës së monitorimit, ka pasur një vazhdimësi të dukshme të praktikës së OSHP-së për nxjerrjen e vendimeve pjesërisht të bazuara, e cila në masë të madhe është reduktuar në gjysmën e parë të vitit 2023. Kjo praktikë, ku ankesat pranohen pjesërisht dhe tarifat e ankesave u kthehen OE, vazhdon të rrisë shqetësimet për procesin e vendimmarrjes së OSHP-së dhe ndikimin e tij në dekurajimin e ankesave joserioze.

Si përfundim, përderisa OSHP-ja ka bërë disa hapa në përmirësimin e transparencës dhe angazhimit të palëve të interesuara, ajo vazhdon të përballlet me sfida të rëndësishme që pengojnë efektivitetin e saj. Raporti përshkruan rekomandimet për adresimin e këtyre çështjeve, me qëllim të përmirësimit të performancës së OSHP-së në të ardhmen.

Analiza Krahasuese: Janar – Qershor 2023 kundrejt Janar – Qershor 2024

Sfidat me të cilat u përball OSHP-ja në vitin 2024 pasqyrojnë nga afër ato të vërejtura në vitin paraprak, me disa çështje kyçe që vazhdojnë. Në të dyja periudhat, OSHP-ja ka pasur probleme me vonesa në vendimarrje, kryesisht për shkak të një bordi të pamjaftueshëm dhe një numri të konsiderueshëm të ankesave të pazgjidhura. Megjithatë, përderisa OSHP-ja në vitin 2023 funksiononte me katër anëtarë pas dorëheqjes së njërit, situata në vitin 2024 u përkeqësua pasi bordi u reduktua në vetëm tre anëtarë për pjesën më të madhe të periudhës. Ky reduktim e sforcoi edhe më shumë kapacitetin e OSHP-së, duke çuar në vonesa më të theksuara dhe joefikasitet operacional.

Për sa i përket transparencës, ndërkohë që pati disa përmirësime në vitin 2024 – veçanërisht në angazhimin e palëve të interesuara dhe ndryshimin e rregullave – çështjet kritike nga viti 2023 mbetën të pazgjidhura. Të dyja periudhat u karakterizuan nga praktika joadekuate të publikimit, çështje teknike me ueb faqen e OSHP-së dhe përdorimi jo konsistent i rekomandimeve të ekspertëve, veçanërisht në rastet teknike. Për më tepër, vazhdimi i vendimeve pjesërisht të bazuara në vitin 2024, një praktikë që pati një reduktim të konsiderueshëm në vitin 2023, sugjeron një regres në përpjekjet e OSHP-së për të përmirësuar procesin e saj të vendimarrjes dhe për të zvogëluar ankesat joserioze.

Në përgjithësi, performanca e OSHP-së në vitin 2024, ndërkohë që tregon disa fusha të progresit, reflekton sfidat e vazhdueshme që ishin gjithashtu të dukshme në vitin 2023. Këto çështje të vazhdueshme nënvizojnë nevojën për reforma më të fuqishme për të përmirësuar efikasitetin, qëndrueshmërinë dhe transparencën e OSHP-së në të ardhmen.

Hyrje

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) është organ i pavarur administrativ i cili ka kompetenca për shqyrtimin e ankesave në prokurim publik nga furnizuesit, ofruesit e shërbimeve dhe/ose kontraktuesin e punëve (të njohur si operatorë ekonomikë). Pas pranimit të ankesës me shkrim lidhur me vendimin e marrë nga autoriteti kontraktues, OSHP-ja ka mandat të shqyrtojë ankesat brenda afateve të përcaktuara me ligj, për të siguruar zgjidhje në kohë. Pas përfundimit të shqyrtimit, OSHP nxjerrë një vendim me shkrim që adreson pretendimet ankimore të palës dhe merr vendim për aktivitetin e prokurimit ndaj të cilit është paraqitur ankesa.

OSHP, në pjesën më të madhe të gjashtëmujorit të parë të vitit 2024 ka funksionuar me vetëm tre anëtarë nga pesë që duhet ti ketë. Kjo pasi, në fund të vitit 2023 një anëtar dha dorëheqje për arsye personale, derisa një tjetër ishte shkarkuar nga Kuvendi i Kosovës nën arsyetimin se kishte shkelur etikën profesionale në rastin e aktivitetit të prokurimit për furnizim me insulina, vendim ky që më pas përfundoi në Gjykatën Kushtetuese, për tu shpallur antikushtetues, në qershor të vitit 2024 nga kjo gjykatë¹. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese gjatë periudhës së raportimit nuk është publikuar ende i plotë, andaj ende nuk dihet se a do kthehet në punë anëtarja e shkarkuar apo jo. Mungesa e dy anëtarëve gjatë shumicës së këtij gjashtëmujori raportues, rrezikoi efikasitetin e bordit, pasi tre anëtarët e mbetur duhej të menaxhonin ngarkesën e shtuar të punës e sforcuar më tej nga bartja e 219 ankesave të pazgjidhura nga viti 2023, në gjysmën e parë të vitit 2024. Në krahasim me gjashtë mujorin e dytë të vitit 2023, numri i ankesave të pranuar ishte më i vogël me 568 sosh, duke shënuar një rënie prej 60 ankesash.

OSHP në krahasim me vitin e kaluar ku vendosi të ndryshonte edhe Rregulloren nr.01/2020 të Punës së OSHP-së saktësisht nënin 21², ndryshim i cili u shoqërua me kritika për shkak të mos transparencës, inicoi ndryshim sërish të Rregullores së Punës, duke përfshirë në diskutim publik³ edhe palët e interesit. Draft Rregullorja edhe pse ishte në dëgjim publik në fillim të vitit 2024, gjatë kësaj periudhe iu nënshtrua ndryshimeve të shumta pas komenteve të pranuar, por që ende nuk është miratuar nga ky organ.

Në prill të vitit 2024, OSHP u bë me katër anëtarë pasi një nga dy emrat e propozuar për këtë pozitë nga Qeveria e Kosovës u votua nga deputetët e Kuvendit me datën 25 prill 2024⁴. Anëtarja e re mori pozitën e saj në fund të muajit maj. Gjatë kësaj periudhe raportuese, OSHP u përball edhe me mungesën e një specialisti të IT-së, kjo pasi personi i angazhuar dha dorëheqje nga ky pozicion në fund të muajit janar. Në muajin shkurt, OSHP shpalli konkurs për angazhimin e një zyrtari në këtë fushë⁵, mirëpo kjo procedurë pasi kaloi fazën e vlerësimit paraprak⁶, u anulua më pastaj në muajin prill⁷, nën arsyetimin se asnjëri nga kandidatët nuk ka arritur pikët e nevojshme për emërim.

1 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese (<https://gjk-ks.org/njoftim-per-vendim-ne-rastin-ko157-23/>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024)

2 Rregullorja e ndryshuar nr. 01.2020 (<https://oshp.rks-gov.net/sq/Documents/Download?id=32d256d8-2a52-ee11-b5bc-005056ba09d5>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024)

3 Draft/Rregullorja e Punës së OSHP-së (<https://oshp.rks-gov.net/sq/Pages/Details?id=6>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024)

4 Vendimi për zgjedhjen e anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit (https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2024_05_02_25_04_2024/Vendim-PerzgjedhjeneanetaritOrganitShqyrtuesteProkurimit_DrhzDXJV3N.pdf), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024)

5 Konkursi i shpallur për zyrtarë të IT-së (<https://oshp.rks-gov.net/sq/Documents/Download?id=22d6722d-fccf-ee11-b5c1-005056ba09d5>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024)

6 Faza e verifikimit paraprak për zyrtarë të IT-së (<https://oshp.rks-gov.net/sq/Documents/Download?id=a6bdc7d5-7df2-ee11-b5c2-005056ba09d5>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024)

7 Vendimi për anulim të konkursit për zyrtarë të IT-së (<https://oshp.rks-gov.net/sq/Documents/Download?id=ed4183d6-7517-ef11-b5c5-005056ba09d5>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024)



Gjatë gjysmës së parë të vitit 2024 OSHP ka funksionuar pa bord të kompletuar

568

ankesa brenda gjashtë muajve

Rregullorja e Re e Punës nuk u miratua

Numri dhe natyra e vendimeve të OSHP-së në gjashtë mujorin e parë të vitit 2024

Numri dhe llojet e vendimeve të OSHP-së në gjashtëmujorin e parë të vitit 2024:

367

vendime

201

ankesa ende në proces

OSHP ka mbajtur

25

seanca dëgjimore

D+ ka monitoruar nxjerrjen e vendimeve nga OSHP nga 1 janari deri në 30 qershor 2024. OSHP-ja për ankesat e parashtuara gjatë kësaj periudhe ka nxjerrë 367 vendime, ndërsa në proces kanë mbetur 201 sosh. Gjatë kësaj periudhe, janë mbajtur gjithsej 25 seanca dëgjimore me palët e përfshira, apo 13 më pak se gjashtëmujori i dytë i vitit 2023.

Kategorizimi i vendimeve të marra gjatë kësaj periudhe raportuese është si më poshtë:



114

vendime kanë qenë në favor të OE që kanë parashtuar ankesa;



253

vendime ishin kundër OE ankues;



Në **64**

raste, vendimet e OSHP-së nuk ishin në përputhje me rekomandimet e ekspertëve.

Nga 367 lëndët e përfunduara:

93

ankesa ishin të palejuara (nuk janë futur fare në shqyrtim, mungon dëshmia e pagesës së tarifës për ankesë, OE ankues nuk ka shfrytëzuar të drejtën e ankimit fillimisht në AK-së siç e parasheh LPP)

9

ankesa ishin jashtë afatit kohor të përcaktuar me ligj (OE ankues nuk ka respektuar afatet ligjore për deponim të ankesës në OSHP). Gjithsej **30 ankesa** palët janë pajtuar dhe PSH nxjerr vendim për pajtim të palëve

Kategorizimi i vendimeve sipas numrit të anëtarëve të panelit shqyrtues:



210

vendime janë nxjerr nga panel individual (një anëtar)



115

vendime janë nxjerr nga panele kogjegjiale (tre anëtar)



42

vendime janë nxjerr nga Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP (ankesa të palejuara, pasafatshme)

Për ankesat e pranuar, shpërndarja është si më poshtë:



133

ankesa kishin të bëjnë me njoftimin për kontratë;



93

ankesa kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit;



337

ankesa kishin të bënin me njoftimet për dhënie të kontratës;



Gjithashtu

5

ankesa të tjera (ankesa për mosnënshkrim të kontratës, ankande).

Kohëzgjatja në marrjen e vendimeve dhe pasojat në prokurim publik

Tejkallimet e afateve ligjore për nxerrjen e vendimeve nga ana e OSHP-së dhe ankesat e OE, mund të rezultojnë në shtyerje të konsiderueshme të investimeve kapitale, duke ndikuar në projekte me vlerë të konsiderueshme për muaj të tërë. Tenderët që kanë ndikim sezonal, janë veçanërisht në rrezik për ndikim negativ tek qytetarët. Pezullimi i këtyre aktiviteteve të prokurimit mund të ketë efekte negative në shërbimet publike dhe infrastrukturën, duke theksuar më tej urgjencën e adresimit dhe zgjidhjes së ankesave në kohë dhe me efikasitet.

Për shembull, në një rast OSHP ishte vonuar 91 ditë në marrjen e një vendimi me të cilin u evidentuan disa shkelje të AK-së, por që vendimi i AK-së mbeti në fuqi për shkak se kontrata në fjalë ishte përmbushur mbi 70 përqind. Bëhet fjalë për tenderin për “Shërbimet e Sigurimit Fizik në Spitalin Përgjithshëm Gjilan” aktivitet ky i inicuar nga Spitali i Përgjithshëm Gjilan. Ankesa në OSHP ishte dorëzuar 9 nëntor 2023 nga operatori “Scorpion”, derisa vendimi nga paneli shqyrtues ishte marrë me 7 shkurt 2024. Eksperti shqyrtues përmes ekspertizës kishte vërtetuar se AK kishte vepruar në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik, nenin 7⁸, i cili parasheh trajtim të barabartë dhe jo diskriminim ndaj operatorëve në një procedurë të prokurimit, në momentin që nuk e kishte ftuar fare në këtë procedurë të negociuar të prokurimit operatorin ankues ani se i njëjti ishte në zbatim të kontratës paraprahe për të njëjtat shërbime. Eksperti në fjalën përfundimtare edhe pse kishte konstatuar se ka shkelje, kishte rekomanduar se në këtë fazë të nënshkrimit të kontratës, ankuesin, Paneli Shqyrtues duhet ta konsideroj si palë pa interes, pasi i njëjti nuk kishte qenë fare pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit. Konstatimet e ekspertit, Paneli Shqyrtues i kishte mbështetur në tërësi, duke vendosur që vendimi i AK-së të mbetet në fuqi. Arsyetimi që kontrata të mos shfuqizohet edhe përkundër shkeljeve të evidentuara të AK-së, kishte ardhur edhe si rezultat se kontrata e nënshkruar nga AK me datë 27.10.2023, e kishte afatin e përfundimit deri më 27.04.2024, që i bie se në kohën kur u nxorr vendimi i PSh-së, ishte shfrytëzuar rreth 70% e saj dhe për një kohë të shkurtër edhe përfundon realizimi i saj. Se vonesa në vendimarrje ishte kyçe për këtë ankesë vërtetohet edhe nga vetë paneli shqyrtues, pasi sipas tyre nëse kontrata do të ishte pa një afat të përfundimit siç AK-të dijnë të përcaktojnë tek kontratat me procedurë të negociuar “kjo kontratë vlen deri në lidhjen e kontratës së re”, atëherë, edhe vendimi i panelit shqyrtues me siguri që të do të ishte ndryshe ose në përputhje me rrethanat. OSHP për shkeljet e konstatuara, i kishte tërhequr vërejtjen AK-së se në rast se ZPP përsërit shkeljet e njëjta atëherë do ti drejtohet KRPP me kërkesë për revokim të certifikatës së prokurimit sipas nenit 25, paragrafit 8 dhe 9 të LPP-së⁹.

OSHP u vonua
93 ditë për ta
cilësuar të palejuar
një ankesë e cila
duhej të refuzohej në
momentin e pranimi

8 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 7 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024)

9 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 25, paragrafi 8 dhe 9 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024)

Në një rast tjetër, OSHP-së i janë dashur 93 ditë që të shpallë një ankesë si të palejuar, derisa në bazë të praktikave të deritanishme për këto vendime OSHP nxjerr vendim administrativ 10 deri 15 ditë nga dita e ankesës. Neni 111, paragrafi 3 i LPP-së¹⁰ parasheh se OSHP, pas pranimit të ankesës, menjëherë do ta shqyrtojë atë për t'u siguruar që ajo i plotëson kushtet, sipas paragrafit 1 të këtij neni OSHP duhet të përfundojë shqyrtimin e ankesës brenda një (1) dite pas pranimit të ankesës. OSHP me datë 11 dhjetor 2023, kishte pranuar ankesën me 995/23 nga OE "Crystal Clear" Sh.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e objekteve-pastrimi i objekteve te KPSH-së dhe QPS-së" inicuar nga "Komuna e Gjakovës" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues. OSHP kishte vërtetuar se OE ankues nuk kishte respektuar nenin 108/A paragrafi 3, pika 1 të LPP-së¹¹ i cili parasheh se operatori ekonomik ankues kërkesën për shqyrtim duhet të dorëzoj tek autoriteti përkatës kontraktues: në qoftë se shkëlja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. OE ankues në rastin në fjalë ankesën e kishte parashtruar një ditë para përfundimit të afatit për dorëzim të ofertave. Por OSHP për ta hedhur si të palejuar ankesën ishte vonuar 93 ditë deri në nxerrjen e vendimit, derisa për lëndët e natyrës së ngjashme (251/24, 432/24, 446/24, 510/24) ku nuk ka nevojë të angazhohet ekspert shqyrtues, procedura deri në nxerrjen e vendimit sipas praktikave të deritanishme të OSHP-së nuk merr më shumë se 10-15 ditë kohë.

Gjatë kësaj periudhe monitoruese, D+ ka vërejtur se për një aktivitet të prokurimit në OSHP edhe pse ishin deponuar dy ankesa të natyrës së ngjashme, vendimi për njëriën nga ankesat është publikuar, ndërsa për tjetrin rast ende jo, kur kanë kaluar më shumë se 90 ditë nga momenti i ankesës. Me 25 shtator 2023, 'Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A' në cilësinë e Autoritetit Kontraktues kishte publikuar 'Njoftimin për Kontratë' lidhur me aktivitetin e prokurimit "Transporti i punëtorëve te KEK-ut", me vlerë të parashikuar 4,482,760.00 euro e ndarë në Lote, ndërsa për Llot 1 kishte shpërblyer me kontratë OE Flutura Reisen. Të pakënaqur me vendimin OE "Autotransporti" Sh.A." dhe "Dita Travel Sh.P.K." kishin deponuar ankesë në OSHP, 313/24¹² respektivisht 314/24¹³ me pretendimin kryesor se OE i rekomanduar për dhënie kontrate nuk kishte plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit që minibuset që do ta realizojnë transportin e punëtorëve të jenë me mbi 18 ulëse. Paneli shqyrtues pas pranimit të ekspertizës nga eksperti shqyrtues, ku rekomandimi ishte i njëjti për të dy ankesat, për ankesën e operatorit "Autotransporti" Sh.A." kishte nxjerr vendim pas 61 ditësh, derisa ankesa e Dita Travel Sh.P.K ende mbetet në proces. Se a bëhet fjalë për ndonjë lëshim teknik, D+ ka kërkuar sqarim nga OSHP, derisa të njëjtit kanë konfirmuar se lënda është ende në proces të shqyrtimit të të gjitha provave dhe pas marrjes së vendimit i njëjti do të publikohet në web faqen zyrtare, duke mos ofruar kështu ndonjë informacion tjetër se pse nuk ka vendim për ankesën në fjalë tash e 90 ditë.

Paneli Shqyrtues për lëndën 313/24 nxorri vendim, ndërsa për 313/24 lënda është ende në process edhe pse ankesat janë të ngjashme dhe i përkasin të njëjtit aktivitet të prokurimit.

Këto vonesa në marrjen e vendimeve, të shkaktuara edhe nga rrethanat e krijuara gjatë kësaj periudhe në OSHP, përfshirë dorëheqjen ose shkarkimin e anëtarëve, sjellin dëme materiale për operatorët ekonomik të përfshirë, dhe kanë ndikuar në mirëqenien e qytetarëve. Vonesat e tilla mund të prishin operacionet dhe investimet e planifikuara të bizneseve, duke ndikuar si në operatorët ekonomikë ashtu edhe në ata publik. Zgjidhja e menjëhershme e ankesave është thelbësore për ekzekutimin pa probleme të projektit dhe për të shmangur pengesat financiare dhe ndërprerjet për të gjitha palët e interesuara.

10 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 111, paragrafi 3 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024)

11 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 108A, paragrafi 3 pika 1 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024)

12 Lënda në OSHP me numër 313/24 (<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/a4ac1bf0-03f8-ee11-b5c3-005056ba09d5>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024)

13 Lënda në OSHP me numër 314/24 (<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/1c3be7af-04f8-ee11-b5c3-005056ba09d5>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024)

Vendimet e OSHP-së të atakuara në gjykata dhe lista diskualifikuese

Nëse parashtruesi i ankesës në OSHP mendon se vendimi përfundimtar ose konstatimi i një paneli shqyrtues është në kundërshtim me faktet ose me LPP-në, parashtruesi sipas nenit 119, paragrafi 1 i LPP-së¹⁴ mund të kërkojë nga Gjykata Themelore shqyrtimin e vendimit. Kërkesa duhet të dorëzohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e publikimit të vendimit të OSHP-së. Gjatë periudhës raportuese, sa i përket padive të ushtruara nga operatorët ekonomik kundër vendimeve të panelit shqyrtues, OSHP nuk ka pranuar asnjë aktvendim për përgjigje në padi për vendimet e PSH-së nga 1 janar – 31 qershor 2024.

Të vetmet shkresa janë ato të Gjykatës Komerciale të cilat i ka pranuar OSHP për këtë periudhë, ku janë 10 aktvendime për kërkesa të operatorëve ekonomik për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të PSH-së, prej të cilave: Nëntë kërkesa të OE për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të PSH-së, janë refuzuar në shkallë të parë dhe dy aktvendime të shkallës së dytë të kësaj gjykate. Ndërsa vetëm një kërkesë e operatorit ekonomik është aprovuar për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të PSH-së. Fjala është për aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i shkollës së mesme ekonomike Isa Boletini”. Ky aktivitet ishte zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës për 2,000,000.00 euro. OE ankues “Arad 94” Sh.P.K e pakënaqur me vendimin e PSH-së e cila ankesën e cilësoi pjesërisht të bazuar por që la në fuqi vendimin e AK-së për dhënie të kontratës iu drejtua gjykatës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, vendim ky që u aprovua, derisa OSHP këtë vendim të gjykatës e atakoi në shkallë të dytë, por që vendimi ende nuk është nxjerr.

Ligji i Prokurimit Publik, neni 99, paragrafi 1¹⁵, parasheh që në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare.

Gjatë periudhës janar-qershor, OSHP-ja ka publikuar vendimet në faqen e internetit për operatorët që janë futur në listën diskualifikuese në përgjigje të kërkesave nga autoritetet kontraktuese. OSHP-ja i ka shtuar tetë operatorë ekonomikë në këtë listë me diskualifikim ó deri 12 muaj. Praktikë e cila nuk ka ndryshuar ende është fakti që kërkesat për diskualifikim nuk publikohen në kohë reale në uebaqe, por të njëjtat janë publike tek pas vendimit që nxjerr OSHP.

OSHP nuk ka pranuar asnjë aktvendim për përgjigje në padi për vendimet e PSH-së

OSHP pranoi 10 aktvendime nga Gjykata Komerciale për kërkesa të OE-ve për shtyrje të ekzekutimit të PSH-së

OSHP-ja i shtoi tetë operatorë në listë diskualifikuese

¹⁴ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 119, paragrafi 1 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024)

¹⁵ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 99, paragrafi 1 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024)

TABELA 1: Lista e operatorëve ekonomik që u futën në listën diskualifikuese (janar-qershor 2024)

KËRKESA NGA AUTORITETI KONTRAKTUES	OPERATORI	VENDIMI I OSHP-SË	KOHËZG-JATJA E DISKUALIFIKIMIT	ARSYESHMËRIA
Ministria e Punëve të Brendshme	Al Ber Sh.P.K.	✘ Diskualifikim	 12 muaj	Deklarata nën betim e falsifikuar
Spitali i Përgjithshëm Gjakovë	Pharma Leader	✘ Diskualifikim	 12 muaj	Falsifikim i katalogut
Ministria e Shëndetësisë	Pharma Leader	✘ Diskualifikim	 12 muaj	Falsifikim dokumenti
Hortikultura	Compass IT Sh.p.k	✘ Diskualifikim	 6 muaj	Dëshmi e falsifikuar e certifikatës
Korporata Energjetike e Kosovës	Ardi&Ari SH.P.K.	✘ Diskualifikim	 6 muaj	Falsifikim i të drejtës në distribuim
Komuna Dragash	Albani Construction SHPK	✘ Diskualifikim	 6 muaj	Vërtetohet/pranon se ka borxhe në ATK
Policia e Kosovës	NTSH Creative Design	✘ Diskualifikim	 6 muaj	Falsifikim i atesteve
Komisioni i Pavarur i Minierave	GeoTECH Sh.p.k.	✘ Diskualifikim	 6 muaj	Nuk dorëzoi dëshmitë në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë

Mungesa e konsistencës në vendimmarrje

OSHP ende nuk ka finalizuar një metodologji të detajuar që mundëson vendime uniforme dhe trajtim të njëjtë të ankesave. Gjatë ngjarjes së lansimit për përdorim të brendshëm të platformës Sistemi për Menaxhimin e Lëndëve (SML), OSHP kishte njoftuar se ky sistem do të ndihmojë bordin e OSHP-së të sigurojë konsistencë në vendimmarrje dhe trajtim të njëjtë të ankesave. SML, i cili është zhvilluar për përdorim të brendshëm, synonte të rriste konsistencën e vendimmarrjes duke mundësuar marrjen e ankesave në një format të lexueshme dhe duke i lejuar bordit të ketë qasje në të gjitha ankesat dhe vendimet rast pas rasti¹⁶. Mirëpo, edhe pse gjatë kësaj periudhe monitoruese pati progres në konsistencën e vendimeve, dhe që OSHP tani përdor një bazë të dhënash të brendshme për këtë qëllim, D+ vërejtur se ka ende hapësirë për përmirësim në këtë drejtim.

Në një rast OSHP nuk ia kishte konfiskuar operatorit ekonomik tarifën e ankesës edhe pse ankuesi ishte tërhequr nga ankesa

Sipas nenit 28 të Rregullores së Punës së OSHP-së¹⁷, në rast se OE ankues tërhiqet nga ankesa para shqyrtimit të ankesës ose emërimit të ekspertit shqyrtues dhe para akt-ekspertizës do të bëhet kthimi i tarifës. Në qoftë se ankuesi e tërheq ankesën pas emërimit të ekspertit dhe pranimit të ekspertizës, atëherë bëhet konfiskimi i tarifës.

Megjithatë, në një rast specifik, OSHP nuk kishte konfiskuar tarifën e ankesës ndaj operatorit ankues edhe pse ankuesi ishte tërhequr nga ankesa. Për aktivitetin e prokurimit 'Shërbimet për asgjësimin e cigareve, produkteve të duhanit dhe mallrave tjera sipas nevojave të DK-së' i iniciuar nga Dogana e Kosovës me vlerë të parashikuar 300,000.00 euro, operatori ekonomik 'Met Bat Sh.P.K kishte dorëzuar ankesë në OSHP kundër vendimit për anulim të procedurës me numër 248/24¹⁸. Eksperti shqyrtues i lëndës, nuk i kishte dhënë të drejtë OE ankues, duke rekomanduar që vendimi për anulim të procedurës së prokurimit nga ana e AK-së të mbetet në fuqi. Me ekspertizën e ekspertit ishin pajtuar autoriteti kontraktues po ashtu edhe operatori ankues që në rastin e ankuesit nënkuptohet që ai tashmë është tërhequr nga ankesa.

Në rastet kur ka pajtim të palëve me ekspertizën, Paneli Shqyrtues nxjerr vendim ku njofton se është arritur pajtim i palëve. Por në rastin e sipër përmendur, Paneli Shqyrtues i është referuar gabim Rregullores së Punës së OSHP-së në rastin kur vendosi të rikthejë tarifën e ankesës ndaj operatorit ankues. Kjo pasi Rregullorja e Punës së OSHP-së, neni 28, paragrafi 1, thotë se ankuesi në rast se tërhiqet nga ankesa pas emërimit të ekspertit dhe pranimit të akt-ekspertizës atëherë bëhet konfiskimi i tarifës në emër të shpenzimeve procedurale. Vendimi i panelit në këtë rast nuk ka konsistencë me vendimet paraprahe. Paneli Shqyrtues në tre raste të tjera, lëndët 126/24, 155/24 dhe 481/24 ku ekspertiza ishte në favor të autoritetit kontraktues, pas pajtimit të palëve ia konfiskoi tarifën operatorëve ankues në emër të shpenzimeve procedurale.

¹⁶ Organi Shqyrtues i Prokurimit, Komunikatë për media, 31.01.2023 (<https://oshp.rks-gov.net/sq/Pages/Details?id=351>)

¹⁷ Rregullorja e punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit (<https://oshp.rks-gov.net/sq/Documents/Download?id=0d49ce49-afc2-eb11-b59b-005056ba09d5>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024)

¹⁸ Numri i vendimit 248/24 (<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/0ba6badf-e082-ee11-b5bd-005056ba09d5>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024)

Vonesat në vendimarrje

OSHP pas pranimit të ankesës nga operatori ekonomik sipas nenit 115 dhe 116 të LPP-së¹⁹ është e obliguar ta publikojë vendimin në uebfaqe brenda 34 ditëve. Eksperti shqyrtues ka 10 ditë kohë për të shqyrtuar ankesën²⁰, përderisa autoriteti kontraktues dhe operatori ekonomik kanë katër ditë kohë për të dhënë përgjigje në ekspertizë²¹. Më pas, OSHP ka 15 ditë kohë për të marrë vendim, dhe brenda pesë ditëve vijuese duhet ta publikojë vendimin²², që gjithsej janë 34 ditë. Në raste të caktuara kur OSHP konsideron se një rast është kompleks, e ka autoritetin të shtyjë afatin për nxjerrjen e vendimit për 20 ditë më së shumti. Në këto raste, OSHP-ja duhet të ofrojë një arsyetim dhe deklaratë për të arsyetuar zgjatjen.

Gjatë periudhës monitoruese, OSHP ka nxjerrur gjithsej 367 vendime mbi ankesat e parashtruara në gjashtë mujorin e parë të vitit 2024. Përveç kësaj, OSHP ka trajtuar 219 lëndë të bartura nga gjashtë mujori i dytë i vitit 2023, duke i llogaritur në total kështu 586 vendime të publikuara nga 1 janari deri më 30 qershor 2024. OSHP edhe gjatë kësaj periudhe raportuese vazhdoi me sfidën e tejkallimit të afatit ligjor për trajtimin e ankesave. Nga 367 vendimet e publikuara për ankesat e vitit 2024, vetëm 122 ankesa u adresuan brenda afatit ligjor të përcaktuar me ligj, prej 34 ditëve. Vlen të theksohet se gjysma e vendimeve ishin ankesa të pasafatshme apo të palejuara, ankesa këto që nuk futen fare në shqyrtim të panelit.

Ashtu siç e rregullon edhe LPP, jashtë periudhës prej 34 ditësh, OSHP e ka autoritetin të shtyjë afatin për nxjerrjen e vendimit për 20 ditë më së shumti, pra në total 54 ditë²³. Megjithatë, këto tejkallime duhet të shoqërohen me një arsyetim dhe deklaratë që arsyeton nevojën e zgjatjes.



367

vendime të OSHP-së
gjatë periudhës janar
qershor 2024

Vetëm

122

vendime brenda
afatit të përcaktuar
me ligj

19 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 115 dhe 116 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024)

20 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji për Prokurim Publik në Kosovë, neni 114, paragrafi 1, (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024)

21 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji për Prokurim Publik në Kosovë, neni 115, paragrafi 1 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024)

22 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji për Prokurim Publik në Kosovë, neni 117, paragrafi 1 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024)

23 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji për Prokurim Publik në Kosovë, neni 117, paragrafi 1 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024)

Për ankesat e parashtruara në periudhën janar-qershor 2024²⁴ në:



122

raste OSHP ka nxjerrë vendim brenda afatit prej **34 ditësh.**



173

raste OSHP ka nxjerrë vendim brenda afatit shtesë, **54 ditë.**



72

raste është tejkaluar periudha prej **54 ditësh.**

Gjatë monitorimit D+²⁵ ka gjetur pesë ankesat me afatin me të gjatë të vendimmarrjes:

996/23

Furnizim me vetura për institucionet e Republikës së Kosovës (Agjencia Qendrore e Prokurimit), 144 ditë deri në vendimmarrje në tri raste

94/24

Mirëmbajtja servisini i automjeteve për tërë kompaninë e KRU Gjakova sh.a (Kompania Rajonale e Ujësjellësit G-JAKOVA SH.A.) 116 ditë deri në vendimmarrje

97/24

Furnizim me artikuj të ndryshëm për të burgosur - kantinë (Shërbimi Korrektues i Kosovës) 115 ditë deri në vendimmarrje

39/24

Furnizim me kamiona për mbeturina për nevojat e NPL Përparimi sh.a. (Ndërmarrje Publike Lokale Përparimi SH.A.), 110 ditë deri në vendimmarrje

25/24

Furnizim me pajisje policore (Policia e Kosovës), 107 ditë deri në vendimmarrje.

²⁴ Të dhëna të konfirmuara në mënyrë zyrtare nga ana e administratës së OSHP-së

²⁵ Të dhënat janë nxjerrë nga uebfaqja e OSHP-së (<https://oshp.rks-gov.net/sq/default/index>)

Vendimet pjesërisht të bazuara dhe mos konfiskimi i tarifës së ankesës

Çdo operatorë ekonomikë, sipas Ligjit të Prokurimit Publik, neni 111, paragrafi 4²⁶ në rast se dëshiron ta kontestojë vendimin e autoritetit kontraktues, në momentin që e deponon ankesën duhet të paguajë një tarifë për tu ankuar që mund të kushtojë nga 100 deri në 5000 euro. Dëshmia e pagesës i bashkangjitet vetë ankesës në përputhje me LPP, neni 111, paragrafi 4.

Sipas Rregullores së Punës së OSHP-së, kur pretendimet ankimore në një ankesë janë të pabazuara, OSHP duhet ta konfiskojë tarifën e ankesës²⁷.

Gjatë periudhës së monitorimit nga D+, tarifa e ankesës ndaj operatorëve ekonomikë (OE) është konfiskuar në 71 raste, me shumë totale prej 134,216.00 euro. Kjo shumë është rreth 15,000.00 euro më pak sesa në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2023²⁸, ku tarifa ishte konfiskuar në 117 raste.

Sipas Rregullores së Punës së OSHP-së, tarifa e ankesës nuk konfiskohet në rast se ankesa është e bazuar, para shqyrtimit të saj ose emërimit të ekspertit dhe para pranimit të ekspertizës ose e njëjta cilësohet e pa lejuar nga ana e OSHP-së. Për dallim nga gjashtë mujori i parë i vitit 2023, OSHP sikurse në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2023 edhe në gjashtëmujorin e parë të vitit 2024, ka vazhduar me praktikën e aprovimit të pjesshëm të ankesave, duke e lënë në fuqi vendimin e AK-së, duke siguruar kështu që tarifa të mos konfiskohet. Gjatë periudhës monitoruese në 58 raste vendimet e panelit shqyrtues ishin pjesërisht të bazuara, por që vendimet e autoriteteve kontraktuese i la në fuqi. Vlen të theksohet se miratimi i pjesshëm i ankesës nuk është specifikuar në asnjë rast në Ligjin e Prokurimit Publik.

Për shembull, në një rast, Paneli Shqyrtues, ishte pajtuar në tërësi me ekspertizën e ekspertit shqyrtues i cili kishte rekomanduar që ankesa të cilësohet pjesërisht e bazuar dhe vendimi i AK-së të mbetet në fuqi, ani se kishte konstatuar parregullësi në procesin e prokurimit. Me 4 nëntor 2023, Shërbimi Korrektues i Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues kishte publikuar 'Njoftimin për Kontratë', lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Servisimi dhe mirëmbajtja e gjeneratorëve në institucionet e Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Instituti të Mjekësisë Ligjore", ndërsa me datën 8 dhjetor, kishte shpërblyer me kontratë OE "Liria Sh.P.K". Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 43,000.00 euro.

Tarifa e ankesës ndaj operatorëve ekonomikë (OE) është konfiskuar në

71

raste, me shumë totale prej **134,216.00 euro**

26 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji për Prokurim Publik në Kosovë, neni 118, paragrafi 4 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024)

27 Rregullorja e punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit (<https://oshp.rks-gov.net/sq/Documents/Download?Id=0d49ce49-afc2-eb11-b59b-005056ba09d5>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024)

28 Raporti monitorimit të OSHP-së nga D+ (janar - qershor 2023), (https://dplus.org/wp-content/uploads/2023/09/18-09-23_Or-gani-Shqyrtues-i-Prokurimit-Monitorim-dhe-rekomandime.pdf)

OSHP për këtë aktivitet kishte pranuar ankesë nga OE "AS Tech Sh.P.K." me nr. 1061/23²⁹, ku njëri nga pretendimet ishte se AK në kërkesën për rishqyrtim të dorëzuar nga OE nuk kishte shqyrtuar fare një pretendim ankimor, derisa kërkesën e kishte refuzuar. Eksperti shqyrtues i angazhuar nga OSHP kishte vërtetuar se në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim AK kishte vendosur arsye të eliminimit, përkundër që të njëjtat nuk janë përmendur në vendimin e AK-së përkatësisht në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, siç e parasheh neni 54 i LPP-së, paragrafi 1, pika 1.2³⁰.

29 Numri i ankesës 1061/24 (<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/e0e18ab7-22a6-ee11-b5bf-005056ba09d5>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024)

30 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji për Prokurim Publik në Kosovë, neni 51, paragrafi 1, pika 1.1 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024)

Transparenca

OSHP edhe gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2024 shënoi progres në ngritjen e transparencës së punës së saj. Megjithatë mbeten disa çështje të cilat kërkojnë adresim në të ardhmen, sidomos tek çështjet teknike. Faqja zyrtare e internetit e OSHP-së, vazhdon të përmendet edhe sot si mjet i vlefshëm që ka rritur në masë të madhe transparencën brenda këtij institucioni, por e njëjta vazhdon të ketë probleme të cilat janë rritur në numër në krahasim me gjashtëmujorin paraprak. Në uebfaqe vazhdon praktika e ngarkimit të dokumenteve në formatin e skenuar, që e pamundëson kërkimin në tekst dhe që dokumenti të lexohet nga kompjuteri.



OSHP-ja shënoi progres në ngritjen e transparencës së punës së saj, por mbeten disa çështje që kërkojnë adresim në të ardhmen



Faqja e OSHP-së vazhdon të ketë mangësi



Kërkesat e AK-së për përfshirje në listën skualifikuese të OE nuk janë të publikuara në uebfaqe

Ky organ, vazhdon të mos i publikoj në uebfaqe, në kohë reale, kërkesat e autoriteteve kontraktuese që kërkojnë që një operator ekonomik, të futet në listën diskualifikuese nën dyshimin se ka paraqitur të dhëna të rreme apo dokumente të falsifikuara. Një pjesë e kërkesës bëhet publike vetëm në rastin kur OSHP merr një vendim lidhur me atë kërkesë. Publikimi i kërkesave të AK-ve për futje në listë diskualifikuese të OE-ve nën pretendimin se kanë shkelur LPP-në, do ndikonte në ngritjen e transparencës në OSHP.

OSHP-ja duhet të tregojë kujdes gjatë publikimit të vendimeve për të shmangur keqkuptimet e mundshme. Për shembull OSHP për ankesën 871/23 kishte krijuar konfuzion pasi fillimisht ankesën e kishte refuzuar si të bazuar, derisa përmes një konkluzioni, këtë lëshim teknik e kishte përmirësuar duke e refuzuar si të pabazuar ankesën. Për më tepër, faqja e internetit përballet me probleme që lidhen me publikimin e gabuar të datave. Shumë ankesa, vendime dhe ekspertiza kanë pasaktësi me datën e publikimit të shënuar në sistem. Në disa raste, data e publikimit të vendimit nga paneli, paraqitet e njëjtë me datën e paraqitjes së ankesës nga operatorët ekonomikë, duke shkaktuar kështu konfuzion. Ky problem është evident në lëndën me numër 870/23³¹ ku shihet se data e ank-

31 Lënda në OSHP me numër 870/23 (<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Search?>), (qasur për herë të fundit me 30 qershor 2024)

esës paraqitet e njëjtë me datën e vendimit nga paneli shqyrtues. Shembull në rastet 899/23³², 127/24³³, 211/24³⁴ ekspertiza nuk është publikuar fare, derisa një pjesë e saj mund të gjendet vetëm tek vendimi i panelit shqyrtues. Gjatë monitorimit është hasur në disa raste kur vendimet siç ka konfirmuar OSHP janë marrë, mirëpo të njëjtat nuk janë publike në uebfaqe (p.sh rastet 951/23, 998/23, 09/24, 14/24, 44/24, 137/24). Tutje, në një rast për ankesën 991/23, vendimi i ngarkuar i takon lëndës 997, derisa për ankesën 816/23 vendimi është publikuar i skanuar dhe e pamundëson kërkimin në tekst.

OSHP pati vonesa në publikimin e vendimeve në uebfaqe

Një çështje tjetër që lidhet me transparencën ka të bëjë me transmetimin e seancave dëgjimore drejtpërdrejt përmes platformës Youtube, e cila vazhdon të ketë probleme. Edhe pse gjatë mbajtjes së seancës mbahet edhe procesverbal me shkrim, operatori ekonomik ankues ka mundësi që seancën pas mbarimit ta shoh edhe përmes platformës Youtube, Mirëpo për të marrë lidhjen e transmetimit, paraprakisht duhet ta paraqes një kërkesë me shkrim në OSHP. Ky organ gjatë kësaj periudhe në disa raste publikoi në uebfaqe linqet e seancave dëgjimore, por që veprimi nuk pati vazhdimësi, kjo edhe për faktin që nuk ka të ngazhuar një ekspert të IT-së.

Linqet e seancave dëgjimore nuk publikohen në vazhdimësi në uebfaqe

Një aspekt tjetër thelbësor rreth transparencës është sigurimi i qasjes së publikut në seancat dëgjimore nëpërmjet transmetimeve të drejtpërdrejta. Fatkeqësisht, orari i mbajtjes së seancave dëgjimore vazhdon të mos përditësohet në uebfaqen e OSHP-së. Kjo e fundit vazhdon ta arsyestoj mos publikimin e orarit të mbajtjes së seancave duke shprehur shqetësime rreth keqpërdorimeve potenciale nga palët e treta. Si rezultat, metoda e vetme për të pasur qasje në transmetime është duke parashtruar kërkesë zyrtare OSHP-së, e cila me pas e përcjellë linkun e transmetimit. Vonesat në përgjigje ndaj këtyre kërkesave mund të kenë pasoja negative për palët e interesit dhe do ndikoj direkt në transparencën e këtij organi.

Gjatë periudhës së raportimit ka pasur raste kur seancat dëgjimore nuk janë transmetuar fare për shkak të problemeve teknike, siç është raportuar nga OSHP-ja. Njëri nga rastet e evidentuara nga D+ është lënda 996/23³⁵. Tutje, për të njëjtën lëndë D+ nuk kishte pranuar ftesë për pjesëmarrje në seancë dëgjimore, derisa këtë lëshim OSHP përmes një përgjigje zyrtare ka deklaruar se ky lëshim ka ndodhur për shkak se zyrtarja përgjegjëse për thirrjen e seancave ka qenë në pushim vjetor.

32 Lënda në OSHP me numër 899/23 (<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Search?>) (qasur për herë të fundit me 30 qershor 2024)

33 Lënda në OSHP me numër 127/24 (<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Search?>) (qasur për herë të fundit me 30 qershor 2024)

34 Lënda në OSHP me numër 211/24 (<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Search?>) (qasur për herë të fundit me 30 qershor 2024)

35 Lënda në OSHP me numër 211/24 (<https://oshp.rks-gov.net/sq/ProcurementActivities/Search?>) (qasur për herë të fundit me 30 qershor 2024)

Angazhimi i ekspertëve, gabimet dhe mostrajtimi i lëndëve në mënyrë adekuate

Nëse OSHP-ja konstaton se ankesa është parashtruar me kohë nga operatori ekonomik dhe i plotëson kushtet sipas paragrafit 1 të Nenit 111³⁶ të LPP-së, do të vazhdojë menjëherë me emërimin e një eksperti për shqyrtim sipas nenit 113³⁷ të ligjit në fjalë.

Sipas nenit 114 të LPP-së³⁸, brenda dhjetë (10) ditësh nga emërimi, eksperti shqyrtues do të shqyrtojë dokumentacionin e prokurimit të autoritetit kontraktues dhe shënimet përkatëse. Nëse konsiderohet e nevojshme ose e përshtatshme, eksperti mund të kryejë intervista me zyrtarë, punonjës ose këshilltarë si nga AK-të ashtu edhe nga pala që ka bërë ankesën. Pas kësaj, eksperti shqyrtues do t'i ofrojë panelit shqyrtues të OSHP-së, ankuesit dhe kryesuesit të AK-së një vlerësim gjithëpërfshirës me shkrim të aktivitetit të prokurimit në fjalë.

Eksperti shqyrtues luan një rol të rëndësishëm në proces duke rekomanduar veprime korigjuuese të nevojshme që duhet të ndërmerren nga autoriteti kontraktues. Këto veprime mund të përfshijnë: anulimin e aktivitetit të prokurimit, dhënies së kontratës ose rezultati i një konkursi të projektimit, zgjatjen e afatit kohor, ndryshimin ose anulimin e një vendimi të autoritetit kontraktues ose marrjen e çfarëdo masave të tjera të nevojshme për të korigjuar shkeljet e bëra nga autoriteti kontraktues³⁹. Gjatë kësaj periudhe është vërejtur se ekspertizat e ekspertëve shqyrtues janë dhënë me kohë.

Caktimi i ekspertëve shqyrtues në OSHP, më parë bëhej në mënyrë manuale, por me integrimin së fundmi të sistemit elektronik brenda OSHP-së tani, ekziston një mekanizëm që gjeneron automatikisht rekomandim të emrave të tre ekspertëve për çdo rast që merret në shqyrtim nga paneli shqyrtues. Nga kjo listë, administrata e OSHP-së emëron ekspertin më të përshtatshëm për të kryer vlerësimin e nevojshëm. Në raportin e kaluar, D+ kishte rekomanduar të ndryshohet forma e caktimit të ekspertëve⁴⁰. D+ ka rekomanduar se sistemi elektronik brenda OSHP-së, duhet në mënyrë automatike të vendos për ekspertin që do ta shqyrtojë lëndën e caktuar, gjë që do të rriste transparencën e punës së OSHP-së. Mirëpo, ky rekomandim nuk është marrë parasysh edhe pse i njëjti tashmë është i përfshirë edhe në Planin e Performancës së OSHP-së por që ende nuk është përbushur.

→ Caktimi i ekspertëve në OSHP ende bëhet në mënyrë gjysmëautomatike

→ Opinionet e ekspertëve në përgjithësi publikohen brenda afateve ligjore

36 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 111 paragrafi 1 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024)

37 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 113, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.05/L-068 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024)

38 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 114, paragrafi 1 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024)

39 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 114 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024)

40 Raporti monitorimit të OSHP-së nga D+ (Janar - qershor 2023), (https://dplus.org/wp-content/uploads/2023/09/18-09-23_Or-gani-Shqyrtues-i-Prokurimit-Monitorim-dhe-rekomandime.pdf)

Sipas OSHP-së, përzgjedhja në mënyrë manuale e ekspertit nga administrata pas rekomandimit të tre emrave nga ana e sistemit vazhdon të bëhet për disa arsye. Këtu përfshihet tendenca për raste të përsëritura, skenarë ku një eksperti mund t'i mungojë ekspertiza e kërkuar profesionale, domosdoshmëria për një ekspert tjetër dhe raste kur kompleksiteti i rasteve kërkon fleksibilitet, duke shmangur kështu kufizimet e panevojshme dhe duke kursyer kohë. D+ qëndron të jetë e përkushtuar ndaj idesë që modifikimi i procesit të përzgjedhjes së ekspertëve veçanërisht duke sugjeruar vetëm një kandidat përmes sistemit, do të kontribuonte në rritjen e transparencës brenda këtij organi. Ky ndryshim në sistem do të duhet të përcillej edhe me mundësinë e ndryshimit të emrit të ekspertit i cili rekomandohet nga sistemi, gjithmonë i shoqëruar me një dokument-arsyetim nga administrata se pse ka ndodhur një ndryshim i tillë.

Sa i përket angazhimit të ekspertëve shqyrtues, gjatë periudhës monitoruese, D+ ka vërejtur se ekspertizat në shumicën e rasteve janë lëshuar duke respektuar afatin ligjor. Megjithatë, disa probleme janë evidentuar duke përfshirë rastet kur mendimet e ekspertëve nuk arrijnë të adresojnë të gjitha pretendimet e shqyrtuara dhe ku ka mangësi në ofrimin e arsyetimit të detajuar brenda opinioneve të lëshuara.

Autoriteti Kontraktues, Komuna e Lipjanit, kishte publikuar njoftim për anulim të aktivitetit të prokurimit 'Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Vrellë të Magurës dhe Gypi furnizues Gllavicë – Babush', me vlerë të parashikuar 135,000.00 euro, nën arsyetimin se ka vendosur gabimisht sasinë e kërkuar në paramasë. Kundër këtij vendimi, ankesë në OSHP kishte parashtruar operatori ekonomik Diamanti Sh.P.K. Eksperti shqyrtues i kësaj lënde edhe pse kishte konstatuar se ka gabime në paramasë, kishte vlerësuar se aktiviteti i prokurimit duhet të kthehet në rivlerësim. Gabimet në paramasë, në raste të caktuara mund të sjellin dëmtim të buxhetit dhe të mos arrihet qëllimi i prokurimit që bien ndesh edhe me nenin 1 të LPP-së⁴¹. Paneli Shqyrtues i kësaj lënde nuk e kishte mbështetur mendimin e ekspertit shqyrtues derisa kishte vendosur që vendimi i AK-së për anulim të procedurës të mbetet në fuqi.

**Në përgjithësi,
opinionet e
ekspertëve
publikohen
brenda afateve
ligjore**

Autoriteti Kontraktues, Polica e Kosovës, kishte publikuar njoftimin për dhënie të kontratës për aktivitetin 'Furnizim me këpucë për Policinë e Kosovës-Ri Tender' me vlerë të parashikuar 1,240,860.00 euro. Kundër këtij vendimi ankesë në OSHP kishte parashtruar operatori ekonomik "Sabit Makiqi B.I". Ankuesi kishte atakuar arsyjen e eliminimit të tij, ku sipas AK-së i njëjti nuk kishte arritur të e përmbush vlerën e kërkuar prej 1.500.000 euro, kontrata të natyrës së ngjashme. Lidhur me këtë ekspert shqyrtues kishte deklaruar se ankuesi kishte ofruar dëshmi dhe referenca të cilat e përmbushin vlerën e kërkuar nga AK, duke rekomanduar që aktiviteti i prokurimit të kthehej në rivlerësim. Por Paneli Shqyrtues kishte vërtetuar se eksperti deri tek ky konstatim kishte ardhur duke mos ofruar asnjë dëshmi se në çfarë mënyre i klasifikon si të ngjajshme këto kontrata, që për panelin shqyrtues nuk ofroi bazë të fortë për ta cilësuar të bazuar pretendimin e palës ankuese, duke e lënë kështu në fuqi vendimin e AK-së.

Në një rast tjetër Autoriteti Kontraktues, Komuna Vushtrri, kishte publikuar njoftimin për dhënie të kontratës për aktivitetin 'Mirëmbajtja e rrugëve të rendit të katërt' me vlerë të parashikuar 130,000.00 euro. Kundër këtij vendimi ankesë në OSHP kishte parashtruar operatori ekonomik "N.N.P. Hysnia". Eksperti shqyrtues i kësaj lënde nuk e kishte trajtuar lëndën drejtë sepse nuk kishte nxjerrë asnjë konstatim dhe kishte ardhur në një përfundim të pasaktë se AK nuk ka kërkuar sqarime shtesë nga OE i rekomanduar në momentin e shqyrtimit të ofertave. Se kërkesë për sqarim shtesë nga ana e AK-së për OE fitues ka pasur e kishte vërtetuar paneli shqyrtues duke publikuar kërkesën e AK-së në vendimin e saj.

⁴¹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 1 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2772>), (qasur për herë të fundit më 30 qershor 2024)

Përfundime

DUKE U BAZUAR NË MONITORIMIN E DYTË GJASHTË MUJOR, OSHP-JA VAZHDON TË PËRBALLET ME DISA SFIDA TË RËNDËSISHME, DUKE PËRFSHIRË:

Vonesat në vendimmarrje

Një çështje e vazhdueshme me të cilën vazhdon të përballet OSHP-ja është mos respektimi i afatave ligjore për publikimin e vendimeve. Ky problem i vazhdueshëm, jo vetëm që ndikon në efikasitetin dhe efektivitetin e procesit të prokurimit publik, por gjithashtu minon besimin e palëve të interesuara në aftësinë e OSHP-së për të zgjidhur ankesat në kohë dhe në mënyrë të drejtë.

Një nga pasojat kryesore të këtyre vonesave është zgjatja e aktiviteteve të prokurimit publik. Kur ankesat nuk adresohen menjëherë dhe vendimet nuk publikohen brenda afatit të përcaktuar, pengohet rrjedha e proceseve të prokurimit. Pasiguri të tilla prekin të gjitha palët e përfshira, duke përfshirë autoritetet kontraktuese dhe OE, dhe potencialisht mund të rezultojnë në vonesa të projekteve, pengesa financiare dhe humbje të mundësive të zhvillimit ekonomik.

Vonesat mund të jenë veçanërisht të dëmshme në rastet kur aktivitetet e prokurimit kanë implikime sezonale ose të ndjeshme ndaj kohës. Për shembull, tenderët që lidhen me mirëmbajtjen e rrugëve ose furnizimi me mallra, mund të kenë mundësi të kufizuara. Vonesat në vendimmarrje mund ta bëjnë qëllimin e këtyre aktiviteteve të bëhet i vjetëruar ose më

pak të rëndësishëm, duke ndikuar negativisht në efikasitetin dhe kosto-efektivitetin e projekteve.

Për më tepër, tejkalimi i afatit ligjor prek integritetin dhe reputacionin e OSHP-së si organ i pavarur dhe i paanshëm përgjegjës për zgjidhjen e kontesteve të prokurimit. Ky dështim për të përmbushur afatet mund të bëjë që palët e interesuara, duke përfshirë OE, AK-të dhe publikun e gjerë, mund ta perceptojnë OSHP-në si joefikase për të përmbushur mandatin e saj, duke çuar në mungesë besimi në këtë institucion.

Mungesa e konsistencës në vendime

OSHP-ja po vazhdon të përballet me një sfidë të madhe me mos konsistencën në vendime, duke ndikuar në besueshmërinë e saj si institucion i caktuar për shqyrtimin e ankesave të prokurimit publik. Mos konsistenca ngre shqetësime për drejtësinë dhe paanshmërinë e procesit të rishikimit duke i bërë palët e interesuara veçanërisht OE-të, të përballet me rezultate të paparshikueshme dhe të ndryshme, duke nxitur kështu pasiguri. Njëri nga rastet kur nuk ka pasur konsistencë në vendimmarrje është lënda 284/24, për të cilën OSHP nuk kishte vepruar njëjtë sikurse

në rastet tjera si 126/24, 155/24 dhe 481/24.

Angazhimi i ekspertëve

Funksionimi efektiv i OSHP-së mbështetet shumë në ekspertizën e ekspertëve të saj shqyrtues. Për të siguruar që OSHP-ja mund të trajtojë ankesat komplekse dhe teknike me saktësi dhe aftësi, është thelbësore që të ketë vazhdimësi në rekrutimin e ekspertëve shqyrtues, zgjerimit të ekspertizës dhe trajnimit të tyre.

Mungesa e transparencës

Transparenca në punën e OSHP-së ka ende nevojë për përmirësim. Kjo përfshin angazhimin e një specialisti të IT-së, transmetimin e të gjitha seancave dëgjimore në internet, mbajtjen e linqeve për qasje publike, publikimin e ankesave dhe vendimeve në një format të lexueshëm në faqen zyrtare të internetit dhe sigurimin e dokumentacionit të duhur, përfshirë këtu edhe publikimin e kërkesave të AK-ve për diskualifikim të OE-ve.

Rekomandime

BAZUAR NË GJETJET SIPAS KËTIJ RAPORTI, D+ REKOMANDON VEPRIMET E MËPOSHTME PËR TË PËRMIRËSUAR PERFORMANCËN E OSHP-SË:

1 Përmirësimi i databazës së të dhënave:

Është jetike që OSHP të rekrutoj një ekspert të IT-së dhe të eliminojnë në masë të madhe gabimet në databazë dhe përfundimisht të ngriten standardet e transparencës së OSHP-së, aksesin e të dhënave, duke çuar në transparencë të përmirësuar dhe operacione të thjeshta.

2 Përzgjedhja e automatizuar e ekspertëve:

të modifikohet sistemi për të gjeneruar emrin e një eksperti të vetëm në vend që të ofrohen tre rekomandime. Ky rregullim do të rrisë transparencën, shmangë favorizimin, dhe rrit llogaridhënien, duke marrë parasysh rolin që luajnë ekspertët në procedurat e OSHP-së.

3 Vlerësimi i performancës së ekspertëve:

të vlerësohet rregullisht performanca dhe cilësia e punës së ekspertit për të siguruar profesionalizëm dhe paanshmëri, veçanërisht në rastet që përfshijnë performancë joadekuate. OSHP-ja

duhet të ketë prioritet rekrutimin e ekspertëve të brendshëm, dhe uljen e rekrutimit të ekspertëve të jashtëm. Fusha në të cilën OSHP duhet të ketë prioritet është ajo e TI-së dhe pajisjeve mjekësore, për të adresuar rastet me saktësi dhe efikasitet më të lartë. Zbatimi i programeve të trajnimit dhe mundësive për mundësi zhvillimi profesional mund të rrisë nivelin e ekspertizës brenda OSHP-së dhe të sigurojë konsistencë më të mirë.

4 Eliminimi i praktikës Ankesa pjesërisht e bazuar:

Të inkurajohen ekspertët shqyrtues që të mos i kategorizojnë rastet si pjesërisht të bazuara, pasi që kjo praktikë e vështirëson procesin e vendimmarrjes për panelin shqyrtues.

5 Publikimi i gjobave të vendosura ndaj autoriteteve kontraktuese:

OSHP të bëjë publike listën e autoriteteve kontraktuese që janë gjobitur për shkak të mos respek-

timit të vendimeve të OSHP-së. Kjo masë do të dekurajonte shkeljet e ardhshme.

6 Kërkesat për diskualifikim:

Të bëhet publike kërkesa për diskualifikim që vjen nga AK për OE. Me publikimin e kërkesave për diskualifikim, do të kishte një pasqyrë të hapur se sa është numri i kërkesave, dhe sa është koha që OSHP-së i duhet të marrë vendim.

7 Transparenca:

Njoftimet për orarin e seancave të bëhen publike në uebfaqe, të bëhet transmetimi i drejtpërdrejtë i të gjitha seancave pasi lënda 996/24 nuk ishte transmetuar. Të jenë të qasshme linqet për seancat e mbajtura në çdo kohë, pasi për lëndët 232/24, 226/24 linqet nuk janë publike, derisa lënda 02/24 është publik linku. Tutje publikimi i ankesave dhe vendimeve të bëhet në një format të qartë dhe të lexueshëm në faqen zyrtare të internetit. Këto veprime rrisin transparencën dhe qasjen e publikut në procedurat e OSHP-së.

